REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 868/20
Datë/Datum. 30.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" – Departamenti i Prokurimit

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 242-20-1190-2-2-2-1

Sa i përket tenderit për: Furnizim dhe shërbime interneti, VPN dhe WLAN për UP- Hasan Prishtina

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

IPKO Telecommunications L.L.C.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Zija Shemsiu, nr. 34, Lagja Ulpianë,
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

049/700-700
(Numri Telefonit)

-
(Numri i Faks-it)

Arianit Duraku
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Arianit.duraku@ipko.com
(Adresa elektronike)

30.10.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)
On behalf of:
A. Paruosay
IPKO
IPKO Telecommunications LLC
Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Më datë 06.04.2020, është publikuar Njoftimi për Kontratë, Nr. i Prokurimit 242-20-1190-2-2-1dhe Nr. të brendshëm 90400/20/015/221, nga ana e Universitetit të Prishtinës, për lëndën e kontratës "Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në platformën elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (*(https://e-prokurimi.rks-gov.net/)*). Afati i fundit për pranimin e tenderëve është përcaktuar data 16.04.2020, ora 14:00 dhe kriteri për dhënie të kontratës është përcaktuar të jetë çmimi më i ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po				**Jo**	X		

IPKO nuk ka marr pjesë në procesin e hapjes së tenderëve. Duke qenë se dorëzimi i tenderëve po bëhet në formë elektronike, nuk po praktikohen pjesëmarrjet në hapje të tenderëve.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			**Jo**	

Më datë 21.10.2020, IPKO ka pranuar Njoftimin mbi Vendimin e AK, se tenderi i IPKO's është refuzuar si rrjedhojë e ankesës së parashtruar nga OE Telekomit të Kovës, pas së cilës OSHP në bazë të Vendimit 266/20 ka urdhëruar anulimin njoftimit te kontrates, duke marr për bazë Vendimin Nr. 05/21 Qeverisë së Republikës së Kosovës. Më datë 23.10.2020, IPKO ka dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim te AK, marr për bazë Vendimin Nr. 05/34 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili shfuqizon Vendimin Nr. 05/21 dhe i cili obligon institucionet të veprojnë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe t'i ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e përcaktuara me ligj dhe të mos kryejnë procedura të prokurimit sipas nenit 3 të LPP, pa vendim të Qeverisë. Më datë 26.10.2020, IPKO ka pranuar Vendimin mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, me lëshime të jashtëzakonshme, ku ndër të tjera, si OE Ankues është specifikuar Telekomi i Kosovës.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenin 1; Neni 2, paragrafi 1; Neni 7, paragrafi 1,2,4 dhe 6 Neni 56.1;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Vendimi për anulimin e lëndës Furnizim dhe shërbime interneti, VPN dhe WLAN për UP- Hasan Prishtina është marr në shkelje flagrante të Ligjit mbi Prokurimin Publik, në fuqi. Vendimi në fjalë konsiston në shkelje të:

- qëllimit të Ligjit mbi Prokurimin Publik, i cili është: të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, dhe të gjitha fondeve të autoriteteve kontraktuese duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do ndiqen, të drejtat që do respektohen dhe detyrimet që do përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë aktivitete të prokurimit; të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
- kërkesave përmbajtësore të Ligjit mbi Prokurimin Publik;
- të barazisë në trajtim dhe jo-diskriminim, pasi që Autoriteti Kontraktues ka dështuar të trajtoj operatorët në mënyrë të barabartë, jo diskriminuese, ka lejuar që aktiviteti i prokurimit të zhvillohet në atë mënyrë që redukton dhe eliminon konkurrencën mes operatorëve ekonomik, ka imponuar krijimin e rrethanave dhe kushteve që rezultojnë në diskriminim ndërmjet operatorëve ekonomik, kështu duke bërë diskriminim në dëm të IPKO's, e në të mirë të operatorit Telekomi i Kosovës kështu duke dështuar të eliminoj praktikat që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik;
- të nenit 56.1, me anë të së cilit përcaktohet se të gjitha kontratat publike do të ipen sipas procedurave të themeluara për seleksionim, me anë të së të cilës nënkuptohet se aktiviteti i prokurimit në fjalë, duhet që të vlerësoj tenderët në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në bazë të LPP.

Anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë, për më tepër konsiston në aplikim të gabuar të neneve përkatëse të LPP, rrjedhimisht në aplikim të gabuar të nenit 9.4, i cili parasheh se "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.", në këtë drejtim duke konsideruar operatorin ekonomik Telekomi i Kosovës si autoritet publik, i cili nuk qëndron, marr për bazë se i njëjti është operator në pronësi publike.

Përmbi të gjitha, vendimi në fjalë, është bazuar në *Vendimin 05/21, të datës 02.04.2020 për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit mbi Prokurimin Publik të shërbimeve telekomunikuese që ofron Telekomi i Kosovës, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore, në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik.* Vendim ky i cili është shfuqizuar me vendimin e dates 07.10.2020, Nr. 05/34, i cili po ashtu, në mënyrë taksative obligon të gjitha institucionet të veprojnë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe t'i ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e përcaktuara me ligj dhe të mos kryejnë procedura të prokurimit sipas nenit 3 të LPP, pa vendim të Qeverisë.

Pra, me anulimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë, IPKO po i nënshtrohet nje diskriminimi i cili na masë dëmton IPKO'n kështu duke mohuar të drejtën në ofrimin e shërbimeve për të cilat është licencuar.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Në këtë mënyrë, IPKO Telecomunciations LLC konsideron se veprimet e Autoritetit Kontraktues janë veprime joligjore dhe dëmtojnë IPKO-n në fitimin e humbur sepse këto praktika mbështesin konkurencën jolojale duke diskriminuar dhe duke përjashtuar IPKO Telecommunications LLC nga një konkurim lojal DHE duke e vendosur atë në një pozitë diskriminuese ndaj konkurrentit Telekomi i Kosovës, kështu duke i pamundësuar IPKO Telecommunciations LLC ngritjen e numrit të përdoruesve që marrin shërbimet e IPKO Telecommunciations L.L.C.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*